



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60//01-20777/21
Kaçanik, 26.07.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII-të (Tetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26 Korrik.2021. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Komiteti për Politikë dhe Financa në këtë mbledhje e ka përbërjen 6 anëtarë, për shkak të kontestimit të vendimit të KK nga MAPL për caktimin e Bekim Koxha nga NISMA anëtar në KPF, në vend të Hafize Sallahi, me çka është thënë se nuk është respektuar barazia gjinore.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin 6 anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi, Festim Neziraj dhe Ramadush Osmani, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Fatlume Guri- Selimi.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VIII-të (Tetë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 26 Korrik, me këtë;

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020;
3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2020;
4. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021; .
5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00183-3, Zona Kadastrale Soponicë, në sipërfaqe, 3591m2, bujqësore Livadhet-livadh i klasës së 5, në emër të Muhamet Malsiu; dhe
6. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për periudhën: Janar-Qershor 2021.

Pika 5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00183-3, Zona Kadastrale Soponicë, në sipërfaqe, 3591m2, bujqësore Livadhet-livadh i klasës së 5, në emër të Muhamet Malsiu, Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli theksoj se në mungesë të materialit hiqet nga rendi i punës kjo pikë dhe e njëjta do të shqyrtohet

në një mbledhje tjetër të KPF kur të ofrohet materiali. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë, rendin e punës e shtoj në votim për aprovim, pa pikën e 5-të dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF –dhe i njëjti u aprovua njëzëri.

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 5 pikëve.

Meqë pika 5 hiqet nga rendi i punës, atëherë pika 6 ç vendoset si pikë e 5 dhe rendi i punës, KPF në këtë mbledhje është si vijon:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020;
3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2020;
4. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;
5. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për periudhën: Janar-Qershor 2021.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VII-të (Shtatë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 25.06.2021 /Lënda: 01Nr. 60//01-1724621.

2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, unë jam i kënaqur me Raportin e Auditorit, raporti ka opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Të gjetjet në Investimet Kapitale, Çështja A3 -Dobësi në menaxhimin e kontratës. të projekti; Zgjerimi i rrugës "Avdurrakim Shehu" thuhet se, menaxheri i kontratës ka aprovuar ndryshime pa miratimin paraprak të zyrtarit kryesor administrativ si vijon: Sasitë sipas specifikacionit teknik të pozicioni 8" Furnizimi dhe vendosja me asfalt beton me trashësi 6cm, përpunimin e trotuarit me gjerësi 1.40m' ishin 2016m2m, ndërsa sipas librit ndërtimor ishin 1836m2 apo 180m2 me pak. Gjithashtu është nënshkruara aneks kontrata ku në 6 pozicione ka pësuar ndryshime të theksuara të sasive, për kundër që vlera totale e aneks kontratës nuk kishte ndryshuar. Kërkoj sqarim për këtë të gjetur se a janë marrë masa, pse janë bërë këto ndryshime nga menaxheri i kontratës. pa miratim të zyrtarit kryesor administrativ.

z. Selim Reka, Në Raportin e Auditorit janë theksuar disa të gjetura, si bartja e mjeteve të pashpenzuara, nuk janë bartur të gjitha të hyrat indirekte në SIMFK dhe vlera e detyrimeve kontingjente të pagzjidhura nuk është bartur në vitin 2020, me çka kjo ndikon në një shpallje jo të drejtë të pasqyrave financiare, pastaj ka mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore etj. Nga

20 rekomandime shihet së janë zbatuar 13. Shqyrtimi i kërkesave ka pasur vonesa, pastaj dobësi në menaxhim të kontratës, në rrugën "Avdyrrahim Shehu" të cilën e potencoj edhe Ekremi, Të ky projekt janë bërë punët shkel e shko. Të e gjetura B1 - thuhet së është bërë rritja e llogarive të arketueshme dhe shpalosja jo e saktë e tyre. Të realizimi i rekomandimeve nga PFV, rekomandimet kanë ardhur duke u zvogëluar nga viti në vit, në vitin 2020 nga 10 rekomandime, 5 rekomandime janë zbatuar, 1 nuk është adresuar ende, 2 pjesërisht dhe 2 nuk aplikohen më.

z. Bahri Selimi, Ne jemi të kënaqur me Raportin e auditorit. Ky raport i auditorit është me i mirë së sa ai i vitit të kaluar, apo së çdo raport tjetër të ZAK, ku është dhënë opinion së pasqyrat financiare prezantojnë pikëpamje të drejtë. Risi është së nga ky vit, auditorët japin edhe konkluzione. Të Investimet kapitale, Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e kontratës, kanë mbetur 180m2 që do të thotë së janë bërë me pak punë. Zyrtari ka qenë me Covid-19 dhe kur u kthyer ka pasur keqkuptim në ditarin e arkës. Puna më terren flet krejt ndryshe d.m.th. është paguar me pak sesa është punuar. Inspektimi në terren nga auditorët ka dalë mirë. Të bartja e mjeteve, është një mos pajtueshmëri me auditorin, është e gjetur si shkelje administrative. Të Tatimi në pronë, askush nuk e ka përmbushur planin si rezultat i Covidit-19. Të Çështja C2, - Mangësi në menaxhimin e regjistrave dhe shpalosja e informatave në PVF, janë marrë masa së nuk janë barazuar të hyrat muaj për muaj. Të pasuritë kapitale dhe jokapitale është e gjetur gabim në krejt komunat së nuk ka funksionuar E-Pasuria. Në vazhdim drejtori i DEFZH, Bahri Selimi dha edhe sqarime të tjera lidhur me të gjeturat në raportin e auditorit.

z. Ekrem Kycyku, Të e gjetura, zgjerimi i rrugës "Avdurrahim Shehu", kontrata nuk nënshkruhet pa aprovim paraprak nga zyrtari kryesor financiar. Mendoj së të ky projekt janë shkelur procedurat.

z. Ramadush Osmani, Raporti i auditorit është një e mirë që shkon në prokurori të shtetit. Nëse zyrtari nuk ka ditur me u barazua me letra, atëherë shkon në procedurë penale.

Kryesuesi i Kuvendit, Është një raport me vlerësim të mirë në raport me komunat tjera. Nëse nuk ka kush diçka, a jeni që ky raport të shkoj në procedurë të KK. Të gjithë njëzëri u pajtuan që raportin me dërguar në procedurë të KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e

Shqyrtoj Raportin e Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020 dhe të njëjtin e Procedon për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Planin e veprimit e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Plani i veprimit sa herë ka qenë mirë i hartuar, ndërkaq çështja është të realizimi , megjithëse edhe realizimi ka shkuar duke u përmirësuar nga viti në vit. Ka qenë mirë 3 rekomandimet e reja të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditorit, mos të kishin qenë fare.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Plan i veprimit t'i adresohet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2020; dhe i njëjti i,
Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi;

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Sqaroj së nga projekti , Blerja e veturave për nevoja të QKMF, 20,000€ do të rialokohen për projektin, Rindërtimi i objektit të QMF në Doganaj, sepse QKMF për momentin nuk ka mungesë të veturave.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i adresohet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për periudhën: Janar-Qershor 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Nga Raporti shihet se janë nxjerrë rekomandime, por të njëjtat kanë mbetur vetëm në letër, sepse nuk është marrë më kush më to. Kishte qenë mirë të afatizohen ato rekomandime dhe të caktohet një bartës për zbatimin e tyre.

z. Ekrem Kyçyku, Shprehi shqetësim për zhurmën e cila po krijohet nga kafiteritë në qytet, me çka qytetarët nuk po kanë mundësi me qëndruar në shtëpitë e tyre. Lidhur me këtë çështje, me një aplikacion iu kam drejtuar policisë, por nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.

Kryetari i Komunës, Për çështjen e zhurmës nga kafiteritë, është e pamundur ne me bërë diçka si komunë në këtë drejtim, sepse kjo është procedurë për me marrë kompaninë e licencuar për matjen e zhurmës.

Kryesuesi i Kuvendit, A jeni që kjo pikë t'i adresohet KK. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së,

KPF e shqyrtoj Raportin e KKS dhe i njëjti shkon për shqyrtim në procedurë të Kuvendit të Komunës.

Për fund Kryesuesi i Kuvendit e njoftoj KPF lidhur me zëvendësimet të cilat janë bërë në KPF në mbledhjen e KK. Anëtarë nga NISMA, Bekim Koxha, i cili e zëvendëson Hafize Sallahi, nuk e kemi ftuar në mbledhje për shkak të një Shkrese të MAPL me të cilën kontestohet Vendimi i KK, së është bërë shkelje e Ligjit për Barazi Gjimore me këtë zëvendësim. Vendimi i KK do të shfuqizohet në mbledhjen e KK. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:35. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF të cilët morën pjesë në këtë mbledhje. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 30 Korrik 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli